# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-457906**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Më 8 tetor votohet harta e re territoriale - Mazhoranca përballë kundërshtimit të PD-së, ja ç'pritet të ndodhë |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/me-8-tetor-votohet-harta-e-re-territoriale-mazhoranca-perballe-kundershtimi-i587093` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 13:52:44 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 14:35:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `cfca5ab11a0a3ac46db728e697638e7b161541b12ecbdd0b54249a31f9e318b7` |
| TEKSTI | `e31fc80ea9d0b5291ea98731c23cd902744004ba74f2714b4c8f6ad1c4eb8374` |
| PAMJA | `36ffda712e2f64e611c8b10d3f7b6a3db47f4cd06d9d59b2a6e8ebf94dd2d1d1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7270f24fa7cba0b2ae7bddbf8514d191619a55f4863e313dc3d25b46f1896513` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7270f24fa7cba0b2ae7bddbf8514d191619a55f4863e313dc3d25b46f1896513`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English



# Më 8 tetor votohet harta e re territoriale - Mazhoranca përballë kundërshtimit të PD-së, ja ç'pritet të ndodhë

19 Shtator 2026, 16:35Bota TEMA



Nëse pagat e magjistratëve për socialistët tashmë janë një kapitull i mbyllur, një tjetër rihapet të hënën.

Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore nis punën në shqyrtimin e ndarjes administrative territoriale, sipas variantit të propozuar nga socialistët.

Drafti i mazhorancës u depozitua në Kuvend në datën 31 korrik, në mënyrë që t'i jepej kohë konsultimit me njësitë vendore, ku javët e fundit, në takim me qytetarët, shkoi edhe vetë Edi Rama.

Nga komisioni në seancë janë parashikuar gati 3 javë kalendarike, ku e enjtja e 8 tetorit është parashikuar si dita kur socialistët do të testohen sërish për kompaktësinë e tyre. Kjo pasi nisma kërkon minimalisht 84 vota, dhe reduktimi i bashkive nga 61 në 46 ka mërzitur jo pak socialistë.

Në 15 bashki që humbin statusin si njësi të pavarura të vetëqeverisjes vendore dhe bashkohen me bashkitë fqinje, me këshilltarë të majtë dhe të djathtë, u bënë bashkë për të ndalur hartën e re në këshillat bashkiakë, por pa sukses.

Kjo do të jetë hera e dytë që socialistët në qeverinë Rama miratojnë ndarje administrative territoriale të vendit, e para në 2014 dhe tani në 2026, dhe ajo që mbetet e pandryshuar është mungesa e konsensusit, ku opozita kërkon një numër më të madh njësish vendore, 100 të tilla, ndërsa socialistët 46.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Italia përgatit mision detar në Detin e Kuq: “Nuk mund të presim burokracinë europiane”]

15:25 Bota

[Përdhunoi gruan britanike në një rrugë të Londrës dhe më pas e kërkoi në spital, dënohet me 21 vite burg algjeriani]

15:15 Bota

Dy dronë të paidentifikuar shkelin hapësirën ajrore të Moldavisë, alarm në Kishinau

15:05 Bota

Danimarka: Groenlanda nuk heq dorë nga sovraniteti i saj pas marrëveshjes me SHBA-në

14:45 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.